



Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë

Prezenca në Shqipëri

**Fjala e Ambasadorit Osmo Lipponen, kreu i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri,
në hapje të
Konferencës Rajonale për Bashkëpunimin në Luftën Kundër Pastrimit të Parave
dhe Financimit të Terrorizmit**

**Hoteli Sheraton, Tiranë, Shqipëri,
26-27 Janar 2004**

Të nderuar ministra, shkëlqesi, miq nga Drejtoritë e Bashkërendimit të Luftës Kundër Pastrimit të Parave në rajon (FIU),

Pasi dëgjova kontributin e rëndësishëm të ministrit Bello dhe ministrit Malaj, do të doja t'ju uroja shkurtimisht mirëseardhjen në emër të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, e cila është një ndër organizatorët e kësaj konference.

Kjo konferencë është shumë e rëndësishme dhe mbahet në kohën e duhur. Lufta kundër krimit të organizuar ndërkombëtar dhe terrorizmit ka një rëndësi parësore për ekonominë në rritje dhe demokracinë në këtë rajon. Këtu ne mund të përpiqemi t'u sigurojmë institucioneve shtetërore mjetet e duhura dhe praktikat më të mira, si dhe të ndihmojmë ekonominë të arrijë një kod të drejtë sjelljeje për të luftuar këtë aktivitet shumë të madh kriminal. Duket se korniza ligjore për ta bërë këtë ekziston. Kohët e fundit, edhe në Shqipëri është vënë re progresi për sa i përket legjislacionit.

Pjesa më e madhe e ekonomive në zhvillim janë sot ideale për pastrimin e parave. Shumica e bizneseve janë të vogla ose të mesme, ekonominë janë *ekonomi cash*, por kriminelët kanë mundësi të kryejnë transaksionet ndërkombëtare nëpërmjet sistemeve bankare dhe atyre informatike, të cilat janë të mjaftueshme. Nga ana tjetër, ata që luftojnë kundër pastrimit të parave, zakonisht, kanë burime shumë të dobëta. Kjo është e vërtetë edhe në rastin e Shqipërisë.

Unë përmenda legjislacionin e ri shqiptar. Tashmë është koha që ky legjislacion të zbatohet. Është e qartë se përveç burimeve të dobëta, zbatimi i ngadaltë i tij ndodh për shkak të mungesës së ekspertizës dhe bashkërendimit midis strukturave të ndryshme. Gjithashtu, në disa raste, duket se ka pak motivim për të vepruar sipas ligjit. Prandaj edhe rezultatet konkrete nuk janë ende ato që presim. Bashkëpunimi i thellë dhe i forcuar mes

jush do të jetë tepër i nevojshëm në këtë punë. Zotimi i Qeverisë, nga sa dëgjova sot këtu, është një premtim për të bërë ndryshimin e nevojshëm.

Pasi studiova programin e kësaj veprimtarie dhe listën e ekspertëve, jam i bindur se kjo Konferencë Rajonale për Bashkëpunimin në Luftën Kundër Pastrimit të Parave dhe Financimit të Terrorizmit do të jetë e suksesshme.

Shpresoj që ju t'i jepni një kontribut të mëtejshëm bashkëpunimit rajonal dhe se Ministria e Financave dhe Drejtoria Shqiptare e Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave do të marrin rekomandimet e nevojshme për punën e tyre në të ardhmen. Edhe OSBE-ja dhe Prezenca e saj në Shqipëri do të përpiqet të gjejnë mënyra dhe mjete për të mbështetur zbatimin e tyre.

Ju uroj një konferencë intensive dhe të suksesshme.